



## Udhëzimi 11

Shtator 2016

### Prokurimi publik

# Mjetet e prokurimit

#### PËRMBAJTJA

- [Marrëveshjet kuadër](#)
- [Ankandet elektronike](#)
- [sistemet dinamike të blerjes](#)
- [Katalogët elektronik](#)
- [Informacion i mëtejshëm](#)

Autorizuar për botim nga Karen Hill, Drejtuese e Programit të SIGMA-s.

Shtetet Anëtare kanë mundësi që të vendosin nëse të zbatojnë ose jo dispozitat që lejojnë përdorimin e katër llojeve të veçanta të mjeteve të prokurimit: marrëveshjet kuadër<sup>1</sup>, ankandet elektronike, sistemet dinamike të blerjes, dhe katalogët elektronik.

Secila nga këto mjete të prokurimit përdor një ose më shumë nga procedurat kryesore konkurruese si pikënisje për procesin e prokurimit që duhet ndjekur.

## Marrëveshjet kuadër

Termi "kuadër" mund të përdoret për të përshkruar një numër marrëveshjesh tregtare dhe të prokurimit. Megjithatë, Direktiva e Sektorit Publik (Direktiva)<sup>2</sup> ofron një përkufizim të veçantë të "marrëveshjes kuadër":

"një marrëveshje ndërmjet një ose më shumë autoriteteve kontraktore dhe një ose më shumë operatorëve ekonomik, qëllimi i së cilës është të përcaktojë kushtet që rregullojnë kontratat që do të jepen gjatë një afati të caktuar kohor, në mënyrë të veçantë në lidhje me çmimin dhe, kur është e përshtatshme, në lidhje me sasinë e parashikuar".

Me fjalë të tjera, marrëveshja kuadër është një term i përgjithshëm për marrëveshje me operatorët ekonomikë që përcaktojnë termat dhe kushtet sipas të cilave mund të bëhen blerje specifike. Përparësia e kontratës publike kuadër është se, me qëllim që ajo të shpallet në fillim në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian (GZBE)* dhe të organizohet dhe të funksionojë në përputhje me dispozitat e Direktivës, ajo nuk ka nevojë që të shpallet sërish në *GZBE* ose të kryhet një proces i plotë i tenderit kur kontratat jepen në bazë të kësaj marrëveshje kuadër.

**Kush mund të hartojë një marrëveshje kuadër?** Marrëveshja kuadër mund të hartohet nga:

- Një autoritet kontraktor individual;
- Një numër autoritetesh kontraktore në një prokurim të përbashkët;
- Autoriteti kontraktor që vepron në emër të vetes dhe të një numri autoritetesh kontraktore;
- Një organ qendror blerjesh që vepron në emër të vet ose të një numri autoritetesh kontraktore.

Kur një marrëveshje kuadër krijohet për të mirën e një numri autoritetesh kontraktore në mënyrë që të përmbushin kërkesat e transparencës, atëherë Njoftimi i Kontratës në *GZBE* duhet të tregojë qartë autoritetet kontraktore që janë palë në marrëveshjen kuadër. Ky njoftim duhet të bëhet ose me emër ose me mjete të tjera, të tilla si referenca ndaj një kategorie të caktuar autoritetesh kontraktore brenda një zone të caktuar në mënyrë të qartë gjeografike (p.sh., "bashkitë e krahinës X ose të rajonit Y"), në mënyrë që autoritetet kontraktore në fjalë të mund të identifikohen lehtë dhe pa mëdyshje.

Autoritetet kontraktore që janë palë në marrëveshjen kuadër mbeten të pandryshuara për të gjithë kohëzgjatjen e marrëveshjes, dhe për këtë arsye autoritetet e reja nuk mund të futen në marrëveshjen kuadër pasi ajo të jetë lidhur.

<sup>1</sup> Marrëveshjet kuadër quhen edhe si "kuadër".


<sup>2</sup> Direktiva 2014/24/BE për prokurimet publike dhe shfuqizimin e Direktivës 2004/18/KE, 26 shkurt 2014.

Disa shembuj të asaj se si hartohen marrëveshjet kuadër


Marrëveshja kuadër (MK) me një furnitor të vetëm ndërmjet një autoriteti kontraktor (AK) dhe një operatori ekonomik (OE).



Marrëveshja kuadër (MK) me një furnitor të vetëm ndërmjet disa autoriteteve kontraktore (AK) dhe një operatori ekonomik (OE).



Marrëveshja kuadër (MK) me shumë furnitorë ndërmjet një autoriteti kontraktore (AK) dhe disa operatorëve ekonomik (OE).



Marrëveshja kuadër (MK) me shumë furnitorë ndërmjet disa autoriteteve kontraktore (AK) dhe disa operatorëve ekonomik (OE).



**A ka një kufizim të numrit të operatorëve ekonomikë që marrin pjesë në një marrëveshje kuadër?**

Ku marrëveshja kuadër krijohet me disa operatorë ekonomikë, atëherë numri i parashikuar ose numri maksimal duhet të tregohet në Njoftimin e Kontratës në GZBE. Numri maksimal ligjor i operatorëve ekonomikë është përcaktuar nga Direktiva. Në terma praktik, kjo ka kuptim për të kufizuar numrin e pjesëmarrësve në mënyrë që, për shembull, të mos ketë shumë pjesëmarrës në një mini-konkurrencë.

Operatorët ekonomik që janë palë në marrëveshjen kuadër mbeten të pandryshuar për të gjithë kohëzgjatjen e marrëveshjes, dhe për këtë arsye autoritetet e reja nuk mund të futen në bashkohet me marrëveshjen kuadër pasi ajo të jetë lidhur.

**A mund të përdoren marrëveshjet kuadër për të gjitha procedurat e prokurimit?**

Marrëveshjet kuadër mund të mos jenë të përshtatshme për të gjitha llojet e blerjes, dhe autoritetet kontraktore duhet të jenë të sigurt se një marrëveshje kuadër do të garantojë një mjet ekonomik dhe efikas për blerje. Rasti kur autoriteti kontraktor ka kërkesa të përsëritura për punë, shërbime ose furnizime, por nuk janë të panjohura sasisë e sakta që kërkohen është përdorimi më i përshtatshëm i marrëveshjeve kuadër.

Autoritetet kontraktore duhet të jenë në gjendje që ta menaxhojnë marrëveshjen kuadër, pasi duhet të plotësohen nevojat e autoritetit ose autoriteteve kontraktore dhe të ofruarit ose të ofruesve, ndërkohë që funksionimi i marrëveshjes kuadër duhet të monitorohet nga afër. Duhet të tregohet kujdes për të garantuar që marrëveshjet kuadër të mos krijohen në mënyrë të tillë që të shtrembërojnë konkurrencën dhe që ato nuk përdoren në mënyrë të papërshtatshme.

**Kur duhet të shpallet një marrëveshje kuadër në GZBE?** Marrëveshja kuadër shpallet me anë të publikimit të Njoftimit të Kontratës në GZBE nëse vlera e parashikuar e të gjitha blerjeve që do të bëhen në bazë të marrëveshjes kuadër kalon pragun përkatës të BE-së për këtë lloj kontrate. Njoftimi i kontratës publikohet në fillim të procesit të krijimit të marrëveshjes kuadër.

Kur llogaritet vlera e kontratës kuadër, duhet të përfshihet vlera maksimale e përlogaritur e të gjitha kontratave të parashikuara për të gjithë kohëzgjatjen e marrëveshjes kuadër. Vlera e përgjithshme nuk përfshin tatimin e vlerës së shtuar. Pasi lidhet marrëveshja kuadër, nuk ka më kërkesë tjetër për të bërë shpallje sa herë që një kontratë jepet në bazë të marrëveshjes kuadër.

**Çfarë procedure është përdorur për të prokuruar një marrëveshje kuadër?** Për prokurimin e një marrëveshje kuadër mund të përdoren secila nga procedurat kryesore konkurruese, edhe pse procedura e hapur dhe procedura e kufizuar janë procedurat më të përdorura.

Duhet të theksohet se një marrëveshje kuadër nuk është një listë e operatorëve ekonomikë të përzgjedhur që janë të kualifikuar për të ofruar punë, shërbime ose furnizime që mbulojnë nga marrëveshja. Për të hyrë në marrëveshjen kuadër operatorët ekonomikë janë të detyruar të kenë oferta që janë kualifikuar dhe dorëzuar për vlerësim nga ana e autoriteteve kontraktore, dhe janë këto oferta që do të ofrojnë bazën e dhënies së kontratave në të ardhmen sipas marrëveshjes kuadër.

**A ka ndonjë kufizim ndaj afatit të marrëveshjes kuadër?** Në përgjithësi, jeta e marrëveshjes publike kuadër nuk mund të kalojë katër vjet. Ajo mund t'i kalojë katër vite vetëm në rrethana të veçanta që janë të justifikuara siç duhet, në mënyrë të veçantë nga objekti i marrëveshjes kuadër.

**Si shpallen fituese kontratat në bazë të marrëveshjes kuadër?**

**Marrëveshja me një operator ekonomik:** Aty ku marrëveshja kuadër është me një operator ekonomik, kontratat jepen në bazë të kushteve të përcaktuara në marrëveshjen kuadër. Autoriteti kontraktor mund t'i kërkojë operatorit ekonomik që të plotësojë ofertën e tij nëse është e nevojshme, por nuk mund të bëhen ndryshime thelbësore të kushteve të përcaktuara në marrëveshjen kuadër.

**Marrëveshja me më shumë se një operator ekonomik:** Ku marrëveshja është me më shumë se një operator ekonomik, autoriteti kontraktor zgjedh në mes të dy mënyrave e dhënies së një kontrate:

- **Shpallja direkt e kontratës fituese:** kontrata i jepet direkt një operatori të caktuar ekonomik duke zbatuar kushtet e përcaktuara në marrëveshjen kuadër pa ri-hapjen e konkurimit;
- **Rihapja e konkurimit:** me anë të organizimit të një konkursi shtesë ku ftohen të marrin pjesë të gjithë operatorët ekonomikë të kualifikuar sipas rregullave në marrëveshjen kuadër ("mini-konkurimi").

Autoritetet kontraktore kanë gjithashtu mundësinë e dhënies së kontratave sipas një marrëveshje kuadër duke përdorur të dy metodat e mësipërme: pjesërisht me anë të dhënies së drejtpërdrejtë dhe pjesërisht me anë të ri-hapjes së konkurimit.

Kur krijohet një marrëveshje kuadër me shumë ofrues, autoritetet kontraktore duhet të tregojnë se si duhet të jepet kontrata, ndërkohë që marrëveshja kuadër duhet të përfshijë dispozita që mbulojnë mënyrën e dhënies së kontratës. Kur autoriteti kontraktor krijon një marrëveshje kuadër me opsionin e përdorimit të dy metodave për dhënien e kontratës, ai duhet vënë më pas të përcaktojë

në marrëveshjen kuadër kriteret objektive që do të përdorë për të vendosur se cilën metodë do të përdorë në një rast të veçantë.

Në të gjitha rastet, palët nuk mund bëjnë asnjë ndryshim thelbësor të kushteve të përcaktuara në marrëveshjen kuadër, dhe dhënia e kontratës nuk duhet të bëhet në mënyrë të papërshtatshme, ose në një mënyrë të tillë që të parandalojë, kufizojë ose të shtrembërojë konkurrencën.

Për më shumë informacion, shih Udhëzimin nr. 19 të SIGMA-s e për Prokurimin Publik, *Marrëveshjet kuadër*.

## Ankandet elektronike

Direktiva përmban një numër dispozitash që nxisin prokurimin elektronik, duke përfshirë përdorimin e ankandeve elektronike (e-ankandeve).

Ankandi elektronik është një metodë e të ftuar të ofertave të rishikuara përfundimtare pas zhvillimit të një procesi të plotë të tenderit. Ai përfshin një sistem elektronik online që përdoret nga operatorët ekonomikë të paraqesin çmime të reja dhe/ose ndryshime të tjera të elementëve të ofertave të tyre për një kontratë të caktuar në kohë reale dhe në konkurrencë të drejtpërdrejtë me operatorët e tjerë ekonomikë.

Autoritetet kontraktore mund t'i përdorin e-ankandet për prokurim vetëm kur specifikimet mund të përcaktohen me saktësi të mjaftueshme. Atyre nuk u lejohet të përdorin e-ankandet për kontrata të caktuara të shërbimeve dhe kontratave punësh që kanë si objekt të tyre punë intelektuale, të tillë si projektimi i punëve. Arsyeja për këtë dispozitë është se objekt i një e-ankand mund të jenë vetëm elementet që janë të përshtatshme për vlerësim automatik nëpërmjet mjeteve elektronike, *pa asnjë ndërhyrje apo vlerësim nga autoriteti kontraktor*. Elementet që janë objekt i vlerësimit automatik duhet të jenë të matshme në mënyrë që ato të mund të shprehen në shifra ose përqindje.

Ka lloje të tjera të blerjeve, për të cilat e-ankandi nuk është metodë e përshtatshme, të tilla si kontratat që përmbajnë nevoja më komplekse duhet të përshtaten për një projekt të caktuar.

Autoriteti kontraktor duhet të mendojë me kujdes në lidhje me përdorimin e duhur të e-ankandeve. Për shembull, kontrata për furnizimin me letër ku lloji dhe cilësia e letrës mund të përcaktohen lehtë dhe ku ka një nivel të mirë të konkurrencës në treg do të jetë e përshtatshme për ankandin elektronik. Kontrata për pajisje komplekse mjekësore, ku një numër produktesh janë të disponueshme, ku të gjitha kanë me specifika paksa të ndryshme, dhe ku ka çështje të ofrimit të shërbimit, nuk ka gjasa të jenë të përshtatshme për një e-ankand.

**Në çfarë faze të procesi të tenderit zhvillohet ankandi elektronik?** E-ankandi është faza e fundit e një procesi të hapur, të kufizuar apo dialogut konkurrues të tenderit, pas marrjes së ofertave fillestare.

E-ankandi mund të përdoret gjithashtu si një mini-konkurrim në bazë të një marrëveshjeje kuadër dhe të një sistemi dinamik blerjeje.

Në të gjitha rastet, për të organizuar një e-ankand, autoriteti kontraktor duhet të tregojë në njoftimin fillestar të kontratës që ka për qëllim për të përdorur këtë mjet të prokurimit.

Autoriteti kontraktor pranon oferta fillestare nga të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës dhe bën një vlerësim të plotë të ofertave përpara se të vazhdojë me një ankand elektronik. Ky vlerësim duhet të kryhet në përputhje me kriterin e para-caktuar të shpalljes së fituesit apo kriterëve dhe koeficientëve të ponderimit.

## Cilët faktorë mund të vlerësojë autoriteti kontraktor në ankandin elektronik?

### Ankandi elektronik mund të bazohet në sa më poshtë vijon:

- paraqitja e çmimeve të reja të rishikuara me ulje kur kontrata jepet në bazë vetëm të çmimit; ose
- Çmimet dhe/ose vlerat e reja të karakteristikave të përcaktuara në dokumentet e prokurimit, ku kontrata jepet në bazë të raportit më të mirë çmim/cilësi.

**A lidhen këto rregulla me realizimin e një ankandi elektronik?** Në Direktivë janë përcaktuar rregulla të hollësishme në lidhje me zhvillimin e e-ankandeve. Kërkesat e rëndësishme që duhen mbajtur parasysh janë:

- Dokumentet e prokurimit duhet të përfshijë të paktën të dhënat e mëposhtme:
  - Karakteristikat, vlerat e së cilave do të jenë objekt i ankandit elektronik, me kusht që karakteristikat e tilla të jenë të matshme dhe të mund të shprehen në shifra ose përqindje;
  - Çdo kufizim për vlerat që mund të paraqiten, siç rezultojnë nga specifikimet në lidhje me objektin e kontratës;
  - Informacionin që do të vihet në dispozicion të ofertuesve në kuadër të e-ankandit dhe, kur kërkohet, momenti kur informacioni do t'u vihet atyre në dispozicion;
  - Informacionin përkatës në lidhje me procesin e ankandit;
  - Kushtet në të cilat ofertuesit do të jetë në gjendje që të konkurrojnë dhe, në veçanti, dallimet minimale që do të jenë të nevojshme gjatë konkurrimit, kur kërkohet;
  - Informacionin përkatës në lidhje me pajisjet elektronike të përdorura dhe marrëveshjet dhe specifikimet teknike për lidhjen e tyre.
- Të gjithë operatorët ekonomikë që kanë dorëzuar oferta të pranueshme duhet të ftohen njëkohësisht për të marrë pjesë në ankandin elektronik në datën dhe orën e caktuar duke përdorur lidhjet në përputhje me udhëzimet e përcaktuara në ftesë.
- Ftesa për të marrë pjesë në ankandin elektronik duhet të përmbajë rezultatin e vlerësimit të plotë të ofertës së vetë ofertuesi përkatëse, por jo në lidhje me ofertat e ofertuesve të tjerë.
- Ftesa duhet të deklarojë formulën matematikore që do të përdoret në e-ankand për të përcaktuar ri-renditjet automatike.
- E-ankandi mund të bëhet në disa faza të njëpasnjëshme. Ankandi nuk fillon më herët se dy ditë pune pas datës në të cilën janë dërguar ftesat.
- Gjatë çdo faze të ankandit elektronik, autoriteti kontraktor është i detyruar t'u komunikojë menjëherë të gjithë tenderuesve informacionin që është i mjaftueshëm të paktën për t'u mundësuar atyre që të konstatojnë renditjen e tyre relative në çdo moment. Kur është treguar më parë, autoriteti kontraktor mund të komunikojë informacione të tjera në lidhje me çmimet ose vlerat e tjera të paraqitura. Ai mund të njoftojë gjithashtu në çdo kohë numrin e pjesëmarrësve në atë fazë të ankandit.
- Identitetet e ofertuesve nuk duhet të zbulohen në asnjë fazë të e-ankandit.

### Si e mbyll autoriteti kontraktor ankandin elektronik dhe shpalljen e kontratës fituese?

Autoriteti kontraktor vendos se si të mbyllë procesin e e-ankandit. Ai mund ta mbyllë ankandin si më poshtë:

- Në datën dhe kohën e specifikuar paraprakisht në ftesën për të marrë pjesë në ankand;
- Kur nuk merr më çmime të reja ose vlera të reja (të cilat plotësojnë kërkesat në lidhje me dallimet minimale) brenda një afati të paracaktuar kohor. Koha e përcaktuar si e nevojshme në mes të marrjes së çmimit të fundit të ri ose të vlerës së re dhe mbylljes së ankandit duhet të thuhet në ftesën që shpallet për të marrë pjesë në ankand;
- Kur numri i fazave të ankandit, siç është specifikuar në ftesën për të marrë pjesë në ankand, ka përfunduar. Kur faza duhet të përfundohen pas kalimit të kohës në mes të marrjes së çmimit të fundit të ri dhe/ose vlerave të reja dhe mbylljes së ankandit, atëherë orari duhet të thuhet në ftesën për të marrë pjesë në ankand.

Kontrata shpallet fituese pas mbylljes së ankandit elektronik dhe në bazë të rezultateve të këtij ankandi.

Shih gjithashtu shih Udhëzimin nr. 17 të SIGMA-s për Prokurimin Publik, *Prokurimi elektronik*.

### Sistemet dinamike të blerjes

Sistemi dinamik i blerjes (SDB) është një sistem tërësisht elektronik që mund të përdoret për blerje të përsëritura të standardizuara. Të gjitha komunikimet në kontekstin e një SDB-je duhet të bëhen vetëm me mjete elektronike. Prandaj, për të ngritur një SDB autoriteti kontraktor duhet të ketë një sistem të bazuar në internet të cilit operatorët ekonomik mund t'i bashkohen në çdo kohë.

Kur vlera e përgjithshme e parashikuar e blerjeve në bazë të SDB-së kalon kufijtë përkatës, atëherë për ngritjen dhe funksionimin e këtij sistemi zbatohet Direktiva.

Autoriteti kontraktor duhet të ndjekë rregullat e procedurës së kufizuar, duke përdorur një proces të përzgjedhjes që do të veprojë për strukturimin e SDB-së, ndërkohë që do të lejojë gjithashtu furnizuesit e rinj që të hyjnë në sistem gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë.

Operatorët e interesuar ekonomik dorëzojnë kërkesat për të marrë pjesë në SDB. Gjatë kësaj faze nuk duhet të dorëzohet asnjë ofertë orientuese. Të gjithë kandidatët që plotësojnë kriteret e përzgjedhjes duhet të pranohen në sistem, dhe nuk ka asnjë kufizim për numrin e kandidatëve të pranuar.

Autoriteti kontraktor duhet të njoftojë operatorin ekonomik në fjalë në rastin e parë të mundshëm, nëse ai është pranuar apo jo në SDB.

Në çdo kohë gjatë periudhës së vlefshmërisë së sistemit, autoriteti kontraktor është i lirë që të kërkojë nga operatorët ekonomik që të paraqesin vetë-deklarimin e ripërtëritë dhe të përditësuar për përmbushjen e kriterëve të përzgjedhjes cilësore, brenda një afatit kohor të përshtatshëm.

Çdo operator ekonomik që ka paraqitur kërkesë për pjesëmarrje dhe ka plotësuar kriteret e përzgjedhjes lejohet të marrë pjesë në procedurat e prokurimit të kryera nëpërmjet SDB-së gjatë periudhës së vlefshmërisë.

Çdo kontratë që një autoritet kontraktor dëshiron të japë në bazë të DPS-së duhet të jetë subjekt i një ftese të veçantë për tender. Autoriteti kontraktor i jep kontratën ofertuesit që ka paraqitur ofertën më të mirë në bazë të kriterëve të dhënies të përcaktuara në ftesën për konkurrim.

**Cilat llojet të blerjeve janë të përshtatshme për një SDB?** Përkufizimi i SDB-së bën të qartë se ai është vetëm për qëllimin e "blerjeve të përdorura zakonisht" dhe i referohet atyre blerje si "përgjithësisht të disponueshme në treg". Këto sisteme janë në përgjithësi të përshtatshme vetëm për blerjen e mallrave kur ka një treg aktiv të artikujve standard.

**Si organizohet një SDB dhe si funksionon ai?** Autoriteti kontraktor fillon procesin duke botuar një thirrje për konkursin për krijimin e sistemit në formatin e kërkuar.



Autoriteti kontraktor duhet të përfshijë në specifikime të paktën të dhënat e mëposhtme:

- Natyrën dhe sasi të vlerësuara të blerjeve të parashikuara;
- Informacionin e nevojshëm në lidhje me sistemin elektronik të blerjes;
- Pajisjet elektronike të përdorura, lidhjet teknike dhe specifikimet.

Autoriteti kontraktor duhet të tregojë çdo ndarje në kategori të produkteve, punëve ose shërbimeve dhe karakteristikat përcaktuese të tyre.

Autoriteti kontraktor duhet të ofrojë akses të pakufizuar, të drejtpërdrejtë dhe të plotë në specifikimet dhe në çdo dokument shtesë, dhe adresa e internetit ku mund të gjenden këto dokumente duhet të tregohet në njoftimin e kontratës. Kjo kërkesë për akses në specifikimet dhe dokumentet shtesë zbatohet që nga data e publikimit të njoftimit të kontratës dhe për kohëzgjatjen e SDB-së.

Operatorët e interesuar ekonomik paraqesin pastaj kërkesa për të marrë pjesë në sistem. Kufiri minimal kohor për pranimin e kërkesave të para për pjesëmarrje duhet të jetë 30 ditë nga data e ftesës për konkurrim. Pasi dërgohet ftesa për ofertë për prokurimin e parë specifik në bazë të SDB-së nuk ka më kufizime të mëtejshme kohore për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje.

Të gjithë kandidatët që plotësojnë kriteret e përzgjedhjes duhet të pranohen në sistem, dhe Autoriteti kontraktor nuk duhet të kufizojë numrin e kandidatëve për t'u pranuar në sistem.

**Funksionimi i sistemit:** Ndryshe nga marrëveshjet kuadër, ku anëtarësimi fiksohet në momentin që krijohet marrëveshja kuadër, në rastin e SDB-së operatorët e rinj ekonomik mund të aplikojnë për të hyrë në sistem në çdo kohë si dhe gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së SDB -së.

Furnizuesit e rinj mund të kërkojnë që të marrin pjesë në SDB në të njëjtat kushte si ata që kanë hyrë në fillim.

Autoriteti kontraktor duhet të finalizojë vlerësimin e kërkesave të tilla, në përputhje me kriteret e përzgjedhjes, brenda 10 ditëve të punës pas marrjes së tyre. Ky afat mund të zgjatet deri në 15 ditë pune në raste të veçanta kur janë të justifikuar, në mënyrë të veçantë për shkak të nevojës për të shqyrtuar dokumentacionin shtesë ose për të verifikuar nëse janë plotësuar apo jo kriteret e përzgjedhjes.

Autoritetit kontraktor nuk i lejohet të kërkojë pagesën e ndonjë tarife nga operatorët ekonomik që i janë bashkuar sistemit. Të gjitha dokumentet duhet të vihen në dispozicion pa pagesë, ndërkohë që për shpenzimet administrative apo për kosto të tjera nuk mund të vihet asnjë lloj tarife.

**Shpallja e kontratës fituese:** Për çdo procedurë prokurimi të kryer në bazë të SDB-së, autoriteti kontraktor fton të gjithë operatorët ekonomik të pranuar që të dorëzojnë një ofertë. Kur sistemi është i ndarë në kategori të punëve, produkteve ose shërbimeve, autoriteti kontraktor fton vetëm ato pjesëmarrës që janë pranuar në kategorinë përkatëse të prokurimit specifik në fjalë që të dorëzojnë ofertë.

Autoriteti kontraktor i jep kontratën ofertuesit që ka paraqitur ofertën më të mirë në bazë të kriterëve të dhënies të përcaktuara në ftesën për konkurrim.

## Katalogët elektronik

Katalogët elektronik (e-katalogët) përfaqësojnë një mjet të ri elektronik të blerjes që mund të ndihmojë për të rritur konkurrencën dhe për të modernizuar blerjet publike, sidomos për sa i përket kursimeve në kohë dhe në para.

### Çfarë janë katalogët elektronik?

Me fjalë të thjeshta, e-katalogu është një version dixhital i katalogut të furnitorit. Në rastin e prokurimit publik, duhet të merren në konsideratë disa rregulla të përgjithshme për të siguruar që përdorimi i katalogut elektronik bëhet në përputhje me parimet e trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit dhe transparencës. Këto rregulla të përgjithshme janë si më poshtë:

- Përdorimi i një e-katalogu për prezantimin e ofertave nuk përmban mundësinë që operatorët ekonomikë të transmetuar katalogët e tyre të përgjithshëm.
- Operatorët ekonomik duhet t'i përshtatin katalogët e tyre të përgjithshëm në funksion të procedurës së veçantë të prokurimit. Kjo përshtatje siguron që katalogu që transmetohet në përgjigje të një procedure të caktuar të prokurimit respekton formatin e vendosur nga autoriteti kontraktor dhe përmban vetëm ato produkte, punë ose shërbimet që korrespondojnë me kërkesat e autoritetit kontraktor.

Si pasojë, e-katalogët jepen në një format për prezantimin dhe organizimin e informacionit në një mënyrë që (1) është e përbashkët për të gjithë ofertuesit pjesëmarrës, dhe (2) i nënshtrohet trajtimit elektronik.

Një shembull tipik i një e-katalogu është një fletë e të dhënave që përmban informacion në lidhje me një produkt të veçantë, të tillë si përshkrimi i tij, prodhuesi i produktit, kodet e produktit, çmimi, njësiti e masës, koha e dorëzimit, imazhet (nëse kërkohet), si dhe çdo informacion tjetër përkatës, në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor.

**Kur dhe si mund të përdoren katalogët elektronik?** Autoriteti kontraktor mund të kërkojë që ofertat të paraqiten në formatin e një katalogu ose mund të përfshijë një e-katalog në të gjitha procedurat e prokurimit, ku është i nevojshëm përdorimi i mjeteve elektronike të komunikimit.

Ku e-katalogët janë të nevojshëm në një proces të prokurimit, autoritetet kontraktore duhet ta tregojnë këtë kërkesë në njoftimin e kontratës dhe të sigurojnë të gjithë informacionin e nevojshëm mbi formatin, pajisjet elektronike që përdoren, strukturimet e lidhjeve teknike dhe specifikimet për katalogun.

E-katalogët vendosen nga ana e operatorëve ekonomik me qëllim që të marrin pjesë në një procedurë të caktuar të prokurimit, në përputhje me specifikimet teknike dhe format e përcaktuara nga autoriteti kontraktor. Ofertat e paraqitura në formën e një e-katalogu mund të shoqërohen me dokumentet e tjera që plotësojnë ofertën.

E-Katalogët mund të "kombinohen" me mjete dhe teknika të tjera të prokurimit, të tilla si marrëveshja kuadër ose SDB-ja.

Kur një marrëveshje kuadër me shumë furnitorë krijohet duke përdorur e-katalogët, autoriteti kontraktor mund të sigurojë që proceset e mini-konkurrimit për mini-kontratat do të bëhen në bazë të katalogëve të përditësuar. Në këtë rast, autoriteti kontraktor mund të përdorë njërin nga dy metodat e mëposhtme:

- Fton ofertuesit për të ridorëzuar e-katalogët e tyre, të përshtatur me kërkesat e kontratës në fjalë; ose
- Njofton ofertuesit që synojnë të nxjerrin nga e-katalogët që tashmë janë dorëzuar informacionin e nevojshëm për të krijuar ofertat që janë përshtatur me kërkesat e kontratës në fjalë.

Megjithatë, autoriteti kontraktor është i detyruar t'u japë ofertuesve mundësi që të refuzojnë një mbledhje të tillë të informacionit dhe t'i japë fituesit, para dhënies së kontratës, mundësinë për të konfirmuar se oferta e përgatitur në këtë formë nuk përmbante asnjë gabim material ose, nga ana tjetër, për ta kundërshtuar ofertën e krijuar.

Autoritetet kontraktore inkurajohen gjithashtu që të përdorin një kombinim të SDB-së e-katalogëve për blerjen e artikujve të mallrave duke kërkuar që ofertat për një kontratë specifike të paraqiten në formatin e një e-katalogu.

## Shërbimet

Direktiva e Shërbimeve<sup>3</sup> përmban dispozita për përdorimin e mjeteve të mëposhtme të prokurimit:

**Marrëveshjet kuadër:** Dispozitat për shërbimet janë më pak të detajuara dhe më pak të përshkruara krahasuar me të parashikuara në Direktivë. Për më shumë detaje, shih Udhëzimin nr. 19 të SIGMA-s për Prokurimin Publik, *Marrëveshjet kuadër*.

**Ankandet elektronike:** Dispozitat për shërbimet janë të ngjashme me ato të parashikuara në Direktivë.

**Sistemet Dinamike të Blerjes:** Dispozitat janë të ngjashme me ato të Direktivës.

**Sistemet e kualifikimit:** Subjektet kontraktore mund të krijojnë dhe të përdorin sistemet e kualifikimit. Sistemet e kualifikimit janë unike për Direktivës së Shërbimeve.

Sistemi i kualifikimit është një sistem fleksibël, në të cilën operatorët ekonomikë të interesuar për të hyrë në kontratë me subjektin kontraktor mund të aplikojnë për t'u regjistruar si ofrues potencialë. Subjekti kontraktor pastaj regjistrohet në sistem disa ose të gjithë këta operatorë ekonomikë. Operatorët ekonomikë të regjistruar formojnë një grup nga e cila subjekti kontraktor mund të tërheqë ata operatorë që ftohen për të konkurruar apo për të negociuar kontrata.

---

<sup>3</sup> Direktiva 2014/25/BE për prokurimet nga subjektet në sektorin e ujit, energjisë, transportit dhe sektorëve të shërbimeve postare dhe shfuqizimin e Direktivës 2004/17/KE, 26 shkurt 2014.

## Informacion i mëtejshëm

### Botimet e SIGMA-s

*Manuali i Trajnimit për Prokurimin Publik* – Moduli C4, Botimet e OECD-së, Paris.

<http://www.sigmaweb.org/publications/public-procurement-training-manual.htm>

Udhëzimet e Prokurimit Publik

<http://www.sigmaweb.org/publications/key-public-procurement-publications.htm>

Udhëzimi i Prokurimit Publik 17, *Prokurimi elektronik*. Botimet e OECD-së, Paris.

Udhëzimi i Prokurimit Publik 19, *Marrëveshjet kuadër*, Botimet e OECD-së, Paris.